



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	17.01.2023	
Primi ljen:		
Njësia Jednica	Nomer Broj	Shtoja Dodatak
15-030/01-3165		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

DATË	17.01.2023
PËR	Daut Azemin, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA	<i>peje</i> Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
LËNDA	Informatë për punën e KKSB-së, për vitin 2022



Në bazë të nenit 13, paragrafi 13.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, ju dërgojmë, Informatën për punën e KKSB-së, për vitin 2022

SHTOJCË: Informata e punës së KKSB-së, për vitin 2022



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN**

**Zyra e Kryetarit të Komunës  
-KKSB**

Nr\_\_\_\_\_

Datë : 10. 01. 2023

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Policinë (Ligji nr. 04/ L-076) , nenit 9 paragrafi 1.8. të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB, përkatësisht UA 03/2012 të MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i komunës së Lipjanit i propozon Kryesuesit të Kuvendit komunal të Lipjanit që të vendos në rend dite :

**Informatë për punën e KKSB të Lipjanit gjatë vitit 2022**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në përbërjen e tanishme është themeluar me vendim të Kuvendit komunal të Lipjanit në mbledhjen e datës 31.01. 2022, Sipas rregullit kuvendi ka nxjerrë Vendimin për emërim të cilin ua ka dërguar të emëruarve, ministrive përkatëse dhe e ka publikuar në Web faqen zyrtare të komunës.

Përfaqësimi i komuniteteve etnike e fetare, institucioneve relevante të sigurisë, shoqërisë civile dhe grupeve me interesa të veçanta në KKSB e komunës sonë është bërë duke respektuar në tërësi udhëzimin administrativ të cituar më lartë.

Kryetari i komunës njëherit Kryesuesi i KKSB ka thirrur dhe ka mbajtur mbledhjet sipas procedurave të parapara me UA ku preferohet që brenda vittit kalendarik të mbahen 6 takime të rregullta dhe takimet tjera mund të mbahen për shkak te ndonjë rrethane të jashtëzakonshme ose shqetësimi apo kërcënim i të sigurisë në territorin e komunës apo te ndonjë komunitet i veçantë.

Këshilli gjatë vitit raportues ka thirrur 6 takime të rregullta . Dy takime të rregullta janë mbajtur me përbërje të zgjeruar për trajtimin e temave të veçanta si dhuna në familje dhe në veçanti dhuna ndaj grave të cilat kanë qenë pjesë e Planit vjetor të veprimit të KKSB . Këto tema me kohë ( në fillim të vitit 2022)

përkatëse të angazhuar po nga KBI. Gjatë vitit janë mbajtur edhe takime tjera të KKSBB ku janë trajtuar tema tjera që kanë të bëjnë me ngritjen e performancës së KKSBB ku nga ekspert të Qeverisë dhe UNDP është trajtuar çështja hartimit të planit vjetor të punës si dhe e raporteve vjetore. Një takim i tretë joformal i iniciuar jashtë KKSBB është mbajtur për të diskutuar disa prej kërcënimeve të cilat po shfaqen tash kohëve të fundit në vendin tonë.

Marrë së bashku KKSBB gjatë vitit 2022 ka mbajtur 6 takime duke realizuar shumicën e aktiviteteve të parapara me Planin Vjetor të Veprimit. Aktivitetet të cilat nuk kanë gjetur zbatim edhe gjatë këtij viti sikurse edhe vite më parë janë ato të cilat kanë pasur kosto financiare.

I nderuara kryesues, të nderuar anëtar të Kuvendit komunal, në përputhje me nenin 9. Paragrafi 1. pika 7. e UA të cituar më lartë kryetari i Komunës - Kryesuesi i KKSBB, - pas propozimit të planit kornizë nga koordinatori i këshillit dhe diskutimeve në forum, me pak vonesë pati aprovuar Planin e veprimit për vitin 2022. Kjo është shkaktuar për dy arsyet kryesore. E para se disa dokumente bazë nuk kishin arritur nga niveli qendror dhe e dyta se anëtarët e KKSBB, - përfaqësues të komuniteteve etnike e fetare, të institucioneve të përfaqësuara, e shoqëria civile nuk kishte bërë propozime të shkruara se cilat brengat dhe shqetësimet e tyre duan fillimisht ti prezantojnë, diskutojnë dhe arsyetojnë para se ato të futen në plan të veprimit.

Ne anëtarët e KKSBB në vazhdimësi kemi punuar sipas aktiviteteve dhe detyrave të përcaktuara me këtë plan por në raste të veçanta edhe sipas kërkesave të komunitetit përkatësisht situatës në terren.

Në planin vjetor të punës së KKSBB rregullisht planifikohen tre lloje aktivitetesh:

- Detyrat e rregullta programore të caktuara me udhëzim administrativ e që përbushin misionin e KKSBB-ve,
- Shqetësimet specifike të komuniteteve të komunës sonë të cilat janë prezentë dhe të cilat kërkojnë zgjidhje dhe
- Shqetësimet akute të cilat nuk janë të parashikueshme e të cilat megjithatë kërkojnë aktivitet të KKSBB dhe të institucioneve profesionale të sigurisë.

Nga përcjellja e rregullt e punës së KKSBB por edhe nga rishikimi i procesverbaleve të takimeve mund të vërehen edhe mangësitë në funksionimin e tij. Po përmendim vetëm disa.:

- Anëtarët e njëjtë aktiv në secilin takim dhe të tjerë prapë të njëjtë që nuk diskutojnë gati asnjëherë,
- Mungesa e vizionit dhe ideve të reja për ti propozuar në Planin Vjetor të Punës
- Mungesa e interesimit për hartimin e PVP dhe Raportit Vjetor ,në vend se të ishte punë kolektive kjo bëhet nga një apo dy individ,

- Interesimi i pamjaftueshëm për të këmbyer më shume informacion lidhur me çështjet e ngritura në takimet paraprake. Ka ndodhur edhe vite më parë që një shqetësim i sigurisë të ngritet nga një anëtar- përfaqësues i komunitetit apo edhe grup anëtarësh , qështja të adresohet drejt një institucion komunal apo të sigurisë për procedim e reagim dhe në takimin pasues nuk është raportuar fare se a është punuar gjë për tejkalimin apo së paku zbutjen e atij kërcënimi.

Në takimet e rregullta përveç anëtarëve gati rregullisht marrin pjesë përfaqësuesit e OSCE, Ekipi LMT i KFOR-it por jo edhe institucionet të cilat sipas udhëzimit administrativ duhet të përcjellin punën e KKSBB-ve. Mbledhjet janë të hapura për publikun, ftesat përveç se individualisht për anëtarët e KKSBB botohen edhe në Web faqen e komunës.

Nga aktivitetet e planikuara me planin vjetor zakonisht po realizohen vetëm aktivitetet apo detyrat rutinore dhe nuk janë realizuar aktivitet të cilat kanë pasur një kosto të implementimit . Aktivitete të parapara me Planin Vjetor të veprimit si vetëdijesimi i popullatës për zjarret në përgjithësi dhe ato malore në veçanti , projekti për trajtimin e qenve endacak as në 2022 sikurse edhe tre vitet e fundit me radhë nuk janë realizuar. Mosrealizimi i tyre duket se po shkaktohet edhe nga fakti se koha e planifikimit të aktiviteteve të KKSBB dallon nga planifikimet tjera buxhetore. Buxheti komunal për vitin pasues përgatitet dhe aprovohet zakonisht në korrik – gusht për vitin e ardhshëm dhe për këtë ne nuk si KKSBB nuk jemi njoftuar asnjëherë ndërsa planifikimi i buxhetit për punën dhe projektet e KKSBB hartohet në fund të dhjetorit dhe fillim të janarit.

Plani vjetor i KKSBB para se të vije për aprovim në KK zakonisht kalon edhe nëpër Komitetin përkatës për Politikë dhe Financa ku diskutohet edhe kostoja financiare . Asnjëherë nuk ka pasur kërkesë nga KPF e as nga Ju të nderuar kuvendar që të anulohet ndonjë projekt i KKSBB apo të reduktohet për shkak të kostos financiare. Edhe ashtu së bashku projektet tona kurrë nuk kanë kaluar shumën katër shifrore.

Për zvogëlimin e kërcënimit nga disa rreziqe si qentë endacak ne ende jemi në kërkim të një rrugë zgjidhjeje regionale dhe afatgjate me komunat fqinje dhe kemi arritur një pëlqim në këtë drejtim dhe po punojmë që këtij aktiviteti ti bashkëngjiten edhe komunat tjera fqinje. Përkundër kësaj ka fare pak shpresë se do të gjendet një zgjidhje e pranueshme dhe me kosto të përballueshme për shkak të legjislacionit evropian të kësaj fushe.

Gjatë vitit nga anëtarët e KKSBB janë ngritur, janë futur në PVP dhe trajtuar edhe shqetësime tjera si ;

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve dhe proçkave,
- Dyshimet e rritura për përdorimin dhe shpërndarjen e substancave narkotike në lokale të ndryshme dhe në shkolla,
- Instalimi i kamerave në shkolla,
- Ndriçimi publik në disa lagje periferike të Lipjanit, dhe në fshatra,
- Rritja e rasteve të dhunës në familje e në veçanti ndaj grave,
- Përshkallëzimi i rasteve nga vjedhjet e rëndomta drejt hyrjes në pronë dhe grabitjes me armë zjarri
- Siguria në rrugë e shqetësime tjera më të vogla ose me karakter lokal.

Në takimet e rregullta të mbajtura gjatë vitit janë ngritur edhe qështje që nuk ishin paraparë me PVP si :

- Fushatat sensibilizuese për shumë dukuri negative nëpër shkolla,
- Mungesa e theksuar e ujit të pijshëm, e funksionimit të kanalizimit , e mungesës së transportit publik, e mirëmbajtjes së varrezave e punimeve të dobëta e pa mbikqyrje edekuete në Janjevë .
- Pamundësia e BIK në Lipjan që në pronën e tyre ( pranë KOS) të ndërtojnë hapësira administrative,
- Vendoja e sinjalizimit horizontal e verikal nëpër rrugët e qytetit dhe në të tjerat që janë në përgjegjësi të komunës,
- Nevoja për shtimin e patrullimeve nga PK sidomos tash kur ndriçimi publik po ndërpritet në orët e vona të natës në gati të gjitha fshatrat,
- Nevoja që sikurse vite më parë patrullimet sidomos për ndalimet dhe parkimet nëpër trotuare e në rrugë qytet të bëhen nga polic me bicikleta,
- Shfrytëzimi- ngasja pa asnë kriter e trotinetave elektrike ( edhe bicikletave) të cilët për të arritur në destinacionin e tyre përdorin jo vetëm rrugët por edhe trotuaret, vendkalimet e këmbësorëve, sheshet , e shtigjet e shitetoreve ,
- Nevoja e angazhimit të zjarrfikësve sezonal për muajt e verës per shkak të mungesës së vazhdueshme të zjarrfikësve profesionist të cilët janë staf i AME/MPB,
- Mundësia e pranimit të donacioneve nga biznese të ndryshme vendore me qëllim të pajisjes së njësisë së zjarrfikësve me pajisje teknike sidomos për intervenime në lartësi( Auto shkallë),
- Rritja sshumë e shpejtë e sulmeve kibernetike, ngacmimive të ndryshme, gjuhës së shfrenuar të urrejtjes në rrjetet sociale,
- Vazhdimi i tepërt i grevës në arsim dhe vështirësitet që kjo shkakton edhe te prindërit dhe të tjerët që prekë ( KKSBB ka nxjerr rekomandim dhe apel për këtë),
- Është ripërsëritur nevoja për koordinim më të mirë të të gjithë institucioneve, ShC, OJQ, QPS, , Bashkësive fetare etj për parandalimin e dhunës në familje e në veçanti ndaj grave. Për këtë është mbajtar takim i

veçant në të cilin nga ana e KBI ishin ftuar për trajtim ekspert të fushave dhe nga departamenti i gruas në BI.

Shqetësime të identifikuara nga anëtarët e EVSB dhe anëtarët e KKSBB të cilat janë shndërruar në aktivitete të realizuara mirë që rrisin nivelin e sigurisë së qytetarëve të komunës sonë janë:

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga bimësia dhe materialeve inerte në to,
- Rregullimi me material solid i segmenteve të shtretërve të cilët kalojnë nëpër disa vendbanime,
- Rregullimi i shumë hapësirave publike të cilat ishin shndërruar në deponi hedhurinash të cilat tani janë gjelbëruar , pasuar me drunjë e bimë dekorative dhe po pajisen edhe me ulëse e aksesor tjerë për lojëra.

Ne jemi të vetëdijshëm se misioni i KKSBB nuk ka përfunduar me kaç. Sigurisht se disa nga çështjet dhe sfidat e trajtuarë për çdo vit kanë për të qenë aktuale edhe për kohë tjera, në ndërkohë do të lindin edhe kërcënime tjera të cilat kërkojnë zgjidhje.

Me respekt.

